



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

03 shkurt 2022, Prizren

THIRRJE PËR APLIKIM

TRAJNIMI PËR PUNIMIN E VESHJEVE TRADICIONALE "DOLLAMAVE"

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës", fton gratë dhe vajzat që të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnimin për punimin e veshjeve tradicionale "dollamave" (veshjeve tradicionale për nuse të punuara me dorë). Trajnimi ka për qëllim të aftësoj pjesëmarrëset për qepjen e dollamave me dorë dhe kështu të rrisë mundësitë e tyre për punë në të ardhmen.

Projekti "Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës" është vazhdimësi e përpjekjeve të EC Ma Ndryshe në mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Projekti ka për qëllim që të kontribuojë në ruajtjen e zanatit të punimit të dollamave përmes promovimit dhe transferimit të njohurive. Projekti përfshin rajonin e Prizrenit dhe aktivitetet do të përfshijnë përfaqësues të të gjitha komuniteteve të këtij rajoni.

Të drejtë aplikimi kanë vajzat dhe gratë e moshës 25 deri 50 vjeç nga të gjitha komunitetet që banojnë në rajonin e Prizrenit (Komuna e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Për këtë cikël të trajnimit do të përzgjidhen 12 pjesëmarrëse dhe pjesëmarrëseve të përzgjedhura jashtë komunës së Prizrenit do të ju mbulohen shpenzimet e transportit. Trajnimi do të zgjasë 4 muaj dhe pjesëmarrëset do të mësojnë zejen tradicionale të punimit të „dollamave“ nga profesionistë më përvojë të gjërë në këtë fushë. Pjesëmarrëset e përzgjedhura obligohen që të përcjellin rregullisht trajnimin dhe zotohen që të angazhohen dhe përkushtohen ndaj veprimtarisë duke krijuar marrëdhënie të mira me grupin dhe stafin e punëtorisë.

Mënyra e aplikimit: aplikimi mund të bëhet duke plotësuar formën online në linkun:

<https://forms.gle/gridQ5jgf1ozczU6> apo përmes plotësimit të aplikacionit në zyret e EC Ma Ndryshe në Prizren (Rr. Fehmi Lladrovci 94, 20000). Për më shumë informata mund të na kontaktoni në: 049 714 024 & 029 222 771.

Afati i aplikimit: afati i fundit për aplikim është data 20 shkurt 2022, ora 00:00. Vetëm pjesëmarrëset e përzgjedhura do të njoftohen/lajmërohen brenda 5 ditëve pas mbylljes së shpalljes. Në rast të mospranimin të kandidateve të përshtatshme, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën e anulimit të kësaj thirrje.

Projekti i EC Ma Ndryshe "Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës" është pjesë e grantit të financuar nga projekti „Trashëgimia Kulturore si nxitëse e dialogut ndërmjet komuniteteve dhe kohezioni social“ që zbatohet nga UNDP në Kosovë dhe financohet nga Instrumenti i Bashkimit Evropian që kontribuon për Paqe dhe Stabilitet (IcSP).

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci, Nr. 94 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 77